



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Doretuar Priljetim/Produkt Received/Delivery	27-12-2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Bj Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHTEK	8488/2022		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1059/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1059/2022 të datës 25.11.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë Prizren, kundër masës disiplinore "Vërejtje" të datës 01.11.2022, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.12.2022, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1059/2022 e datës 25.11.2022, e parashtruar nga ankuesi

II. Anulohet masa disiplinore "Vërejtje" e shqiptuar ndaj ankuesit përmes aktit me numër reference: 03/2022 të datës 01.11.2022 të Zëvendësuesit të Udhëheqësit të Divizionit të Kualitetit të Mbledhjes në Administratën Tatimore të Kosovës.

III. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale e nëpunëses civile si dhe regjistri përkatës masën disiplinore të anuluar si në pikën II.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, më datë 25.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 7409/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore "Vërejtje" e shqiptuar ndaj ankuesit përmes shkresës-aktit me numër reference: 03/2022 të datës 01.11.2022 të Zëvendësuesit të Udhëheqësit të Divizionit të Kualitetit të Mbledhjes në Administratën Tatimore të Kosovës, me pretendimet

ankimore se masa disiplinore e goditur me ankesë është shqiptuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 02.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Administratën Tatimore të Kosovës, ndërsa kjo e fundit me datë 13.12.2022 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 7409/2022 të datës 25.11.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Emalin e datës 01.11.2022 të drejtuar Aktin më numër reference: 03/2022 të datës 01.11.2022 të Zëvendësuesit të Udhëheqësit të Divizionit të Kualitetit të Mbledhjes në Administratën Tatimore të Kosovës; Emalin e datës 14.01.2022 të drejtuar Emalin e datës 14.01.2022 të drejtuar Emalin e datës 14.01.2022 të drejtuar Planin operativ vjetor në trajnimin e rasteve sipas Divizionit të kualitetit të mbledhjes me numër reference 01/2022 të datës 14.01.2022; Emalin e datës 03.10.2022 të drejtuar ; Listën e distribuimit me numër reference 08/2022 të datës 03.10.2022; Emalin e datës 03.10.2022 të drejtuar Emalin e datës 03.10.2022 të drejtuar .Emalin e datës 03.10.2022 të drejtuar Mail-Atk; Emalin e datës 17.10.2022 Raportin javor për periudhën 10.10.2022 deri me 14.10.2022 të ankuesit; Emalin e datës 02.10.2022 të drejtuar Raportin javor për periudhën 17.10.2022 deri me 21.10.2022; Shkresën e datës 21.11.2022 lidhur me vijueshmërinë e punës; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 7609/2022 të datës 02.12.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 7951/2022 të datës 13.12.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 18.01.2022; Formularin e datës 10.01.2022 për planin individual të punës për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2022; Formularin e rezultateve në punë të datës 06.01.2021; Formularin për planin individual të punës për periudhën Janar-Dhjetor 2021; Emalin e datës 09.12.2022 të drejtuar Emalin e datës 09.12.2022 të drejtuar Emalin e datës 08.11.2022 të drejtuar Emalin e datës 08.11.2022 drejtuar Emalin e datës 01.11.2022 të drejtuar Emalin e datës 01.11.2022 të drejtuar ; Emalin e datës 08.11.2022 të drejtuar ; Emalin e datës 08.11.2022 të drejtuar ; Emalin e datës 07.11.2022 të drejtuar Emalin e datës 07.11.2022 të drejtuar Emalin e datës 22.11.2022 të drejtuar Emalin e datës 18.11.2022 të drejtuar Emalin e datës 22.11.2022 të drejtuar Emalin e datës 18.11.2022 të drejtuar

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, SEPSE:

Nga administrimi i provave materiale rezulton së ankuesi është e punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, përkatësisht i njëjti sipas Akt-it të Emërimit me numër protokollit 02/960/11 të datës 25.10.2019 është i emëruar në pozitën e punës "Zyrtar i Lartë i Mbledhjes së Detyrueshme," në Divizionin e Kualitetit të Mbledhjes së Detyrueshme me koeficient 8.5 të pagës.



Me datë 01.11.2022 Zëvendësuesi i Udhëheqësit të Divizionit të Kualitetit të Mbledhjes në Administratën Tatimore të Kosovës, në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore "Vërejtje", me arsyetimin se i njëjti nuk ka respektuar orarin e punës dhe nuk ka përmbushur detyrat e punës me kohë, duke konstatuar se ankuesi ka bërë shkelje të rëndë disiplinore të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon së masa disiplinore e kundërshtuar më ankesë është shqiptuar me shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale, sepse shkeljet e ankuesit janë cilësuar si shkelje e rëndë disiplinore ndërsa masa disiplinore është shqiptuar për shkelje të lehta disiplinore duke vepruar kështu në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht:

Nenit 45 më të cilin është përcaktuar se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i dulur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit".

Nenit 46 me të cilin është përcaktuar se: "... Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë. 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar.

Nenit 47 paragrafi 1 më të cilin në mënyrë taksative janë përcaktuar masat disiplinore: "Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil".

Nenit 48 me të cilin është përcaktuar kompetenca lëndore për shqyrtimin e masave disiplinore "1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil..



Rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore Kolegji ka analizuar provat ndërlidhur me këtë çështje juridiko-administrative si dhe aktin për shqiptimin e masës së goditur më ankesë, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit ka shqiptuar masën disiplinore "vërejtje" ndaj ankuesit me konstatimin së i njëjti ka kryer shkelje të rënda disiplinore, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 8 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë lidhur me nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse mbi bazën e këtyre dispozitave ligjore mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit ka kompetencë lëndore që të shqiptoj vetëm masën disiplinore "Vërejtje" për shkelje të lehta disiplinore, përkatësisht në rastin kur një nëpunës civil pretendohet të ketë kryer shkelje të rënda disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, atëherë, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil duhet të inicioj procedurë disiplinore në Komisionin Disiplinor të institucionit përkatës publik.

Andaj, në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 dhe 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një akt administrativ i nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj dhe nga organi publik pa pasur kompetencë, është akt i paligjshëm, kështu që nisur nga fakti së masa disiplinore e atakuar me ankesë është shqiptuar nga organi jo kompetent, Kolegji nuk u lëshua në konstatimin e ligjshmërisë materiale të pretendimeve ankimore të ngritura në ankesë.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1059/2022.

Ilire Mehmeti Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.